

VENDIM
Nr.19, datë 23.3.2005

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PËRMBAJTJEN E PROGRAMIT TË
RISIGURIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE AFATET KOHORE TË
PARAQITJES PRANË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE”**

Në mbështetje të shkronjave “i” dhe “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve” dhe të pikës 6 të nenit 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare dhe në buletin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

3. Udhëzimi t’u dërgohet për zbatim shoqërive të sigurimit.
Ky vendim hyn në fuqi më 23.3.2005.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba